

“KOMUNITETI I FSHATIT” SHTUPEÇ I VOGËL PEJË



RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR SISTEMIN E UJESJELLESIT NE SHTUPEÇ TË VOGËL

Pejë
Gusht -2024

Numri i projektit	10/2024	VITI Gusht /2024
Investitori :	Komuniteti i fshatit Shtupeç i Vogël	
Emërtimi i objektit :	NDERTIMI I SISTEMIT PER FURNIZIMI ME UJE PER FSHATIN SHTUPEÇ I VOGEL, KK-PEJE	
Lokacioni :	Shtupeç i Vogel	
Përmbajtja :	Pozita gjeografike, Shtrirja e ssystemit per furnizim me uje te pijes Mjedisi dhe ndikimet , Marrja masave , Rehabilitimi	
Autorë të raportit, Persona fizikë të licencuar:	Dr.sc. Selim Frangu ing.dipl.gjeologjisë Mr.sc.Bislim Fetahaj ing.dipl.i gjeologjisë	
Bashkpunetor	Msc.Leutrim Frangu, Hidrogjeolog- gjeologjinxhinierike	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Zivotne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planing and Infrstruature

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.08L/181 dhe Udhëzimi Administrativ për Licencim të Hartuesëve të Raporteve për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.10/2017, Ministri i MMPHI lëshon:

Nr. i licencës: 83/18/23

LICENCË

Selim FRANGU
Inxhinier i diplomuar i Gjeologjisë
Licencohet si person fizik për hartimin e raporteve të VNM-së

Data e vlefshmërisë:
19.10.2023— 18.10.2028
Prishtinë



1.0 Hyrje


Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), është bërë në bazë të kërkesës së banorëve të fshatit Shtupeçi Vogël të cilët synojnë ndërtimin e sistemit për furnizim me ujë të pijshëm për banorët e këtij fshati. Për këtë qëllim këta kanë bërë edhe Projektin Teknik për kaptazhë të burimeve ujore të kësaj zone, për rezervuar qendror dhe për shtrirje të rrjetit të gypave për furnizim me ujë të pijshëm për të gjithë banorët e këtij fshati.

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis është bërë në bazë të këtij projekti teknik dhe në bazë të ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës për Mbrojtje të Mjedisit, Ligjeve për Ujëra dhe për të drejtën e furnizimeve me ujëra për të gjithë banorët e Kosovës.

Shtupeç i Vogël është fshat që i përket KK-Pejë në Njesin kadastrale, Shtupeç; burimet e ujit të gjitha i përkasin këtij fshati-kësaj zone si dhe rrjeti furnizues me ujë shtrihet po në zona që i përkasin këtij fshati. Qëllimi i këtij vlerësimi është përgaditja e dokumenteve për aplikim të marrjes së Pëlqimit Mjedisor për fillimin e ndërtimit të këtij projekti shumë të domosdoshëm për banorët e këtij fshati dhe për zonën në terësi e cila është e kategorizuar si Zonë e Mbrojtur me vlera të mëdha natyrore dhe për zhvillim të turizmit malor dhe ringjallje të kësaj zone, përkatësisht rikëthimit të jetës në këtë fshat të bukur i cili është pjesë e kompleksit bjeshkës së Rugovës.

Në Ortofoton e mëposhtme janë paraqit shtrirja e shtepivë të këtij fshati, burimet e ujit për kaptazhë, sistemi i shtrirjes së kanaleve për vendosje të gypave furnizues, pikat e rezervuarëve të grumbullimit të ujerave të pijshëm. Hartuesi i Projektit Teknik për furnizim me ujë të pijshëm për këtë fshat përveç tjerash ka pas parasysh edhe zvoglimin minimal të ndikimit në mjedis gjatë tërë punëve teknike për realizim të këtij projekti. Kështu i gjithë rrjeti i kanaleve për vendosje të gypave furnizues do të vendoset për gjatë rrugës së këtij fshati. Kjo rrugë është në ndërtim e sipër me investime nga Komuna e Pejës. Po ashtu komuniteti pret që edhe financimi për realizimin e këtij projekti të bëhet nga komuna e Pejës ose edhe Qeveria.

Në raport do të analizohet gjitha ndikimet në mjedis gjatë realizimit të projektit, masat mbrojtëse gjatë punës, kaptazha e burimeve ujore dhe burimet të cilat duhen të lihen të lira të cilat janë të nevojshme për ekuilibrin natyror të ekosistemit që lidhet me ujin.



Autori, para fillimit të punës për hartimin e VNM-së, ka dal në teren së bashku me hartuesin e projektit teknik dhe përfaqshuesin e banorëve të këtij fshati dhe persefermi janë vizitue të gjitha burimet natyrore të ujit të pijshem, të gjithë rrugën në të cilën do të shtrihen gypat furnizues, vendet ku do të ndertohen rezervuaret e ujit dhe tereni në terësi. Të gjitha burimet e ujit (shih fotot në vazhdim) janë në gjendje të keqe, jo të mirëmbajtur, disa janë marrë me gypa në mënyrë individuale për nevoja të banorëve, disa të tjerë janë të mbuluar e të pa mirëmbjtur sepse lufta ka bër që banoret të largohen nga ky fshat i bukur edhe ma nuk kanë pas kushte të kethehen në trojet e tyre. Të gjitha burimet, përkundër thatësisë së madhe gjatë kësaj vere, janë me rrjedhje të vogël ose edhe të mirë sipas kohës, sezonës.

Tash, në kte fashat jeta ka fillue të gjallërohet, të ndërtohen shtëpi për banim dhe bujtina për zhvillim të turizmit. Realizimi i këtij projekti do të jetë një shtytje e madhe për

jetë normale në këto hapësirë dhe për zhvillim të turizmit malor. Sidomos tash mbasi është duke u ndërtuar edhe rruga e cila krijon qasje të lehtë më Pejën dhe ansjelltas.

2.0 Baza ligjore për hartimin e raportit të VNM

Mbrojtjen e Mjedisit (03/L-025) është dokumenti juridik i nivelit më të lartë mjedisor në Kosovë që rregullon parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes, rregullon monitorimin e mjedisit dhe përcakton parimet e përdorimit racional të burimeve natyrore. Sipas këtij ligji, projektet e planifikuara, përfshirë ndryshimet në teknologji, rindërtimin, dhe zgjerimin e objekteve ose ndërprerjen e operacioneve, të cilat mund të rezultojnë në ndikim të theksuar mjedisor ose që përbëjnë rrezik për shëndetin e njeriut, kërkojnë Vlerësimin paraprak të Ndikimit në Mjedis (VNM). Procedura për zbatimin e VNM përshkruhet në ligjin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (08/L-181).

Kosova ka bërë përparim të mirë në miratimin e legjislacionit primar dhe sekondar për sektorin e ujit. Primarë janë: (i) Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit; (ii) Ligji për Ujërat e Kosovës; (iii) Ligji për Rregullimin e Shërbimeve Ujore; dhe (iv) Ligji për Shëndetin Publik (në lidhje me cilësinë e ujit të pijshëm) që aktualisht janë në fuqi. Legjislacioni sekondar është miratuar gjithashtu në përputhje me direktivat e Komisionit Evropian dhe procedurat e licensimit, lejës dhe kontrollit përcaktohen në fushat e mëposhtme: (a) Administrimi i Burimeve Ujore; (b) Administrimi i Mbeturinave; (c) Planifikimi Hapësinor/Urban dhe Strehimi dhe Ndërtimi; (d) Mbrojtjen e Natyrës dhe Biodiversitetin; dhe (e) Mbrojtjen e Mjedisit. Autoriteti përgjegjës për qeverisjen dhe menaxhimin e burimeve ujore është MMPHI e mbështetur nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), e cila monitoron gjendjen e mjedisit, përfshirë burimet ujore. Përmbledhja e dokumenteve ligjore që rregullojnë aktualisht sektorin e menaxhimit të ujërave dhe ujërave të zeza në Kosovë përbëhet nga ligjet e mëposhtme parësore dhe dytësore:

- Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, ose Ligji i Ujërave;
- Ligji Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve Ujore, Ndryshohet/Plotësohet nga ligji Nr. 06/L-088;
- Ligji Nr. 08/L-048 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-78 për Shëndetësinë Publike;
- Ligji Nr. 08/L-094 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-09 për Ujitjen e Tokave Bujqësore;
- Udhëzimi Administrativ (UA) Nr.03 / 2018 "Për Procedurat për Leje Ujore";
- UA Nr. 15/2017 "për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit" Ndryshohet/Plotësohet nga ligji Udhëzimi Administrativ Nr. 11/22. 11
- UA Nr. 16/2017 "për Klasifikimin e Trupave Ujorë Sipërfaqësorë";
- UA Nr. 17/2017 "për Klasifikimin e Trupave Ujorë Nëntokësorë";

- UA Nr. 09/2017 "Udhëzim për Projektimin, Ndërtimin dhe Përdorimin e Digave";
- UA Nr. 05/2016 "për Rregullimin e Statusit të Pasurisë Ujore";
- UA Nr. 04/2016 "për Kriteret dhe Procedurat për Mbrojtjen e Brigjeve të Ujë rrjedhave dhe Akumulacioneve";
- UA Nr. 06/2021 "për Strukturën e Pagesave të Ujit";
- Rregullore Nr. 02/2016 "për Mënyrën e Përcaktimit të Prurjes së Pranueshme Ekologjike";
- UA Nr. 19/2015 "për Mbrojtjen nga Veprimet e Dëmshme të Ujërave";
- UA Nr. 02/2022 "për Kushtet, Mënyrat, Parametrat dhe Vlerat Kufizuese të Shkarkimit të Ujërave të Ndotura në Rrjetin e Kanalizimit Publik dhe në Trupin Ujor";
- UA Nr. 12/2013 "Sistemi i Informimit për Ujëra";
- UA Nr. 10/2021 (QRK) "për Cilësinë e Ujit të destinuar për Konsum Njerëzor";
- Strategjitë, planet dhe dokumentet tjera: o Strategjia e Ujërave të Kosovës 2017 – 2036

Udhëzimet Administrative

- Udhëzimi administrativ Nr.04/2022 për Lejen Mjedisore;
- Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;
- Udhëzimi administrativ Nr.30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor;

Udhëzim Administrativ (MMPHI) Nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe trupin ujor.

Gjatë hartimit të raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, përpos vizitave që iu janë bërë lokalitetit disa herë, konsultimeve që janë bërë me pronarin dhe ekspertët që e udhëheqin procesin teknik për Ndërtimin e sistemit për furnizim me ujë për fshatin Shtupeç i Vogël gjithashtu janë shfrytëzuar edhe:

Krahas parashikimeve themelore nga rregullativat ligjore të cekura më lartë për nevoja të hartimit të raportit të VNM-s për rastin konkret janë shfrytëzuar edhe rregullativa tjera ligjore, duke përfshirë ligjet aplikative të cilat tani janë në fuqi. Duke u nis nga fakti se një pjesë e madhe e mardhënjeve specifike nga lëmia e mjedisit nuk është përfshirë në

rregullativat ligjore të tanishme prandaj për nevoja të hartimit të këtij raporti të VNM-s është shfrytëzuar përvoja e mirë dhe rregullat relevante ndërkombëtare, si dhe direktivat përkatëse për mjedis si që është direktiva e VNM-s (85/337/EEC), gjithashtu janë shfrytëzuar edhe raportet e vlerësimit të ndikimit në mjedis për Ndërtimin e sistemit për furnizim me uje për regionin e Hidromoraves dhe asaj të Radoniqit.

3.0 PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT

Tereni ku është e parapar të kryhen punimet për Ndërtimin e sistemit për furnizim me uje për fshatin Shtupeç i Vogël, i perket teresisht këtij fshati. Pra edhe kapatazha e burimeve të ujit, edhe tereni në të cilin do të shtrihet rrjeti i gupave të ujit është komplet në zonen e fshatit Shtupeç i Vogël. Për hartimin e Raportit, hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë teren si në aspektet gjeologjike, hidrogjeologjike, hidrografike ashtu edhe në aspektet tjera si zonë mjedisore e mbrojtur.

3.1.Pozita gjeografike e lokacionit

Rugova është rajoni malor që ndodhet në veri-perendim të qytetit të Pejës . Ndryshe bjeshka e Rugovës i takon rajonit të Bjeshkeve të Nemuna që ndryshe këto bjeshkë njihen edhe si Alpet Shqipëtare. Në vitin 2013 ky rajon u shpal edhe Park Kombëtar. Në regionin e Rugovës shtrihen 13 fshatra të shpërndarë në të gjithë rajonit të Rugovës në të dy anët e rrjedhjes së Lumbardhit të Pejës. Së cili fshat është më i bukur së tjetra dhe së bashku e përbëjnë panoramen e bukurisë dhe krenarisë së Kosovës.

Fshatrat Shtupeç i Madh dhe Shtupeç i Vogël janë fshatrat më të afërt me qytetin e Pejës dhe shtrihen në anën e majtë në drejtim të rrjedhjes së Lumbardhit. Fshati Shtupeç i Vogël shtrihet në pjesën veri-perendimore të Pejës. Rruga që e lidhë kete fshat me rrugën kryesore Pejë-Rugovë nuk është e rregulluar, rrugë rurale më zhavorë. Prej rruges kryesore Pejë-Rugovë e deri në Qafë të këtij fshati largësia është rreth 10km. Brenda fshatit më kontribut të vetë banorëve janë ndërtuar edhe disa rrugë lokale që lidhin lagjet e këtij fshati. Tereni është tipik alpin më thyrje të mëdha, më gryka, më maja të larta, shkëmbinjë të thepisur, më ujëvara, më shpella karstike e më burime të shumta të ujit të ftohtë, liqene glaciale, majat e larta (Hajla-2403m; Guri i Kuq=1522m; Maja e Maeiasht etj.).

Punimet për ndërtimin e rrugës së re janë në zhvillim e sipër. Pjesa më e madhe e rrjetit të kanaleve në të cilin do të vendosen gypat furnizues të ujit , parashihet të kaloj

pergjatë trases së kësaj rruge. (Fig.2). Realizimi i këtij projekti ka një ndikim të madh për banorët e fshatit Shtupeçi Vogël do të krijohen të mundësitë të furnizimit me uje popullata vendase dhe turistet e mundshem të zonës së përfshir brenda zonës së burimeve. Gjithsesi kjo pjese ku do të kryhet ndërtimi i sistemit për furnizim me uje për fshatin Shtupeç i Vogël krijon një vlerë të lartë ekonomike, ekoturizem dhe se pozita morfologjike e terrenit si dhe pozita gjeografike i japin dimensione shtesë me rëndësi këtij investimi.

Ne pjesen veriore të fshatit shtrihen burimet e ujerave të cilat janë në projekt për furnizim të këtij fshati me ujë të pijës,(burimi B1,B2,B3, B4 ,B5,B6,B7 dhe B8) Fig.1





Fig.1 Pamja ne ortofoto e burimeve te parapara per shfrytezim nga Komuniteti Shtupeç i Vogël



Fig.2.Pozita gjeografike e zonës së ndërtimit te sistemit për furnizim me uje për fshatin Shtupeq i Vogël, KK .Peje



a) Pamja në ortofoto e zonës së Shtupeqit të Vogël

Terreni në të cilin planifikohet të bëhet ndërtimi i sistemit për furnizim me uje për fshatin Shtupeq i Vogël, është brenda kufijve të ngastrave të shënuara në kopjen e planit (fig.2).

3.2. Popullata dhe Vendbanimet

Zhvillimi demografik i komunës së Pejës është dhënë në tabelen nr.1. Nuk po ndalem në interpretim të tabelës sepse fjala është për lokalitetin e ngusht të fshatit Shtupeç i Vogël. Banorët e këtij fshati janë të ndarë sipas lagjeve: Lagja Ibërdemaj; Broç; Kastrat; Nilaj; Beqiraj dhe Bajraktar. Që të gjitha këto lagje do të përfshihen në rrjetin e furnizimit më ujë të pijshëm.

Tabela 1. Të dhënat nga regjistrimet e popullsisë në periudhat prej vitit 1948 – 2011.

Tabela 1. Të dhënat nga regjistrimet e popullsisë në periudhat prej vitit 1948 – 2011.

Viti	Popullsia		Ekonomitë Familjare (EF)		Madhësia e familjes (numri i anëtareve në ekonomitë familjare)		Pjesëmarrja e qytetit në komunë (%)	
	Komuna	Qyteti	Komuna	Qyteti	Komuna	Qyteti	Ekonomitë familjare	Popullsia
1948	46.750	17.277	8.357	4.051	5.6	4.3	48.5	37.0
1953	53.280	21.058	9.120	4.598	5.8	4.6	50.4	39.5
1961	66.656	28.351	11.405	5.948	5.8	4.8	52.2	42.5
1971	90.124	41.853	14.231	8.069	6.3	5.2	56.7	46.4
1981	111.071	54.497	16.967	9.885	6.5	5.5	58.3	49.1
1991 ¹	127.796	68.163	19.859	12.228	6.4	5.6	61.6	53.3
2011	96.450	48.962	17.682	9.800	5.5	5.0	55.4	50.8

Gjatë hartimit të Raporti të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është analizuar në terësi ndikimi në mjedis i rrjetit të kanaleve ku do të vendosen gypat, kaptazha e venburimeve, kurse specifikimet tjera teknike janë pjesë e projektit teknik. I gjithë fshati, përkatësisht shumica e banoreve të këtij fshati nuk janë rezident gjatë tërë vitit, megjithëse po vërehet një frymë e re në këtë fshat dhe më gjerë. Kjo po shihet më ndërtimet e reja dhe më themelet e reja që i pam gjatë shkëlqës së terenit. Po ashtu pamë edhe restorante të reja e bujtina shumë atraktive.

3.3. Lidhjet e Komunikacionit

Lokacioni ku do të ndertohet sistemi me furnizim me ujë nga burimet lidhet me rrugën e pashtuar që kalon në këtë mjedis dhe lidhet me rrugën e asfaltuar Pejë -Rugovë rrugë e cila mundeson lëvizjen e komunitetit dhe vizitoreve në këtë fshat.

Qyteti i Pejës është 5-7km nga pjesa ku kyqet me rrugën që na qon në drejtim të fshatit Shtupeç i Vogël.

Nga kjo mund të përfundojmë se lokacioni ka lidhje të mira komunikacioni , me të cilën rritet vlera nga aspekti ekonomik, ekoturist, me qëllim të nje jete me te rehatshem te komunitetit dhe vizitoreve ne keto pjese te Shtupecit.

3.4. Kushtet klimatike

Rugova është regjion në vete sa i përketë klimës dhe kushteve të tjera klimaterike. Veç tjerash është bjeshkë me karakteristika alpine; verera të shkutëra e të fresketa dhe dimëra të gjatë, më borë shumë dhe të temperatura të uleta. Gati tere verës nuk shkrinë bora në majat e larta, karakteristikë kjo për terrenet alpine.

Klima e rajonit të Pejës sipas pozitës së saj gjeografike, lartësisë mbi detare dhe sipas të dhënave meteorologjike (siq janë: reshjet dhe temperaturat mesatare mujore dhe vjetore), i gjithë regjioni i gjerë mund të ndahet në dy zonën më klimë të ngrohet e ndikuar nga rrymat e ngrohta mesdhetare dhe zona malore, bjeshka me klimë të ftohtë kontinentale. Pranvera dhe Vjeshta karakterizohen përafërsisht me klimë të njëjtë. Të reshurat janë të formës riguese ose me karakter lokal. Shuma e përgjithshme e reshjeve sillet nga 670 mm deri ne 820 mm. Lagështia mesatare vjetore është 55,58 %.

3.4.1. Temperatura mesatare mujore

Regjioni i bjeshkëve të Rugovës benë përjashtim nga regjimi i temperaturave mesatare mujore e vjetore të pjesëve të tjera të territorit të komunës së Pejës. Më poshtë po japim shenimet për temperaturat në gjithë teritorrin e Pejës. Temperatura mesatare sillet prej 10,5°C gjer në 11,5°C e si mesatare e këtyre merret temperatura prej 11,0°C. Temperaturat më të larta janë në muajin qershor 35,6°C, ndërsa në korrik 32,4°C dhe në gusht 31,1°C. Temperaturat më të ulta janë në muajin dhjetor, janar dhe shkurt. Temperaturat maksimale mesatare vjetore janë 22,5°C, ndërsa temperaturat mesatare minimale sillen prej -2.5°C. Temperatura ekstreme me e ulet e regjistruar ne Peje është -17 °C. Amplituda mesatare vjetore është 25 °C. Lëkundjet termike prej vitit në vitë janë mjaft të theksuara. Vlerat ekstreme pozitive të temperaturave në Kosovë lëvizin në mes +37 dhe 39 °C, ndërsa vlerat ekstreme negative në mes -17 °C dhe 32,4 °C. Kështu vlerat ekstreme termike në Pejë, arrijnë deri në 49.4 °C.Me rritjen e lartësisë mbidetare temperatura e ajrit bie. Në viset e larta malore temperatura mesatare maksimale në gusht është rreth 22 °C, kurse temperatura mesatare minimale në janar është -8.0 °C. Kështu në pjesët malore amplitudat vjetore termike janë më të vogla dhe arrijnë rreth 14 °C.

3.4.2. Erërat

Erërat me drejtimet e lëvizjes dhe shpejtësinë e tyre janë faktor i rëndësishëm në formimin e kushteve të jetës, por edhe në përcaktimin e ndikimeve mjedisore. Regjioni karakterizohet kryesisht me erëra nga drejtimet e veriut (12 %), veri-lindja (30), dhe perëndimi (24 %), ndërsa më së paku fryjnë erëra e lindjes (11 %), jugut (6 %) dhe jug-lindja (2 %). Shpejtësia mesatare e erërave në Pejë është 1.3 m/s. Pozita gjeografike e rrethuar me Bjeshkët e Nemuna e mbron komunën nga erërat e intensitet të lartë.

3.5. Relievi

Relievi i Bjeshkës së Rugovës është imponant dhe karakterizohet më thyrje e kontraste të mëdha. Është reliev gëlqerorë më shpate të rrëpinjta, gryka të thella e të ngushta erozive. Faqet e malit janë me pjerrëtësi 15° - 30° por ka raste edhe pingul, 90° . Ndërtimi gjeologjik më dominim të gëlqerorëve, morfologjia e terrenit, rrjedhja e ujërave sipërfaqësore, reshjet e mëdha të deboret si dhe elemente të tjera të tektonikës kanë krijuar një reliefë imponantë më bukuri përrallore. Morfologjia e terrenit të fshatit është e thyer kodrinoro malore me lartësi mbidetare deri 1596m Kukavica ne perendim , kurse ne lindje te Maja Vjelakut K. 2014m. Ne pjesen veriore të lokacionit shtrihen burimet ujore që janë pjesë e kaptazhës B1,B2,B3, B4 ,B5,B6,B7 dhe B8 (Fig.1) Pjesa ku paraqiten burimet e ujit perfaqesohet nga gelqeror te Triasikut.

3.6. Hidrogjeologjia

Karakteristikat hidrogjeologjike të gelqerore në Shtupeç që dominojnë në ndërtimin e kësaj zone kadastrale kanë karakteristika të mira akumuluese të ujërave nëntokësor. Gelqeroret ndërtojnë kaverna, shpella ashtu që një pjesë e ujërave sipërfaqësore drenohet në pjesët anësore të gelqeroreve e pastaj drenohen në neper kaverna dhe kalojnë deri në pjesën e prrockave dhe lugines në drejtim të Lumbardhit të Pejës.

Morfologjia, ndërtimi gjeologjik, tektonika janë faktorët dominantë të cilët definojnë lëvizjen e ujërave sipërfaqësor dhe ato nëntokësor.

Punimet gjatë rregullimit të sistemit për furnizim me ujë nëntokësor, gjegjësisht burimeve nuk do të ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore si dhe nëntokësore pasi

që komuniteti duhej të ketë ne mbikqyerje ne vazhdimesi mirmbajtjen dhe mos damtimin e vegjetacionit ne keto pjese, gjegjesishte edhe ruajtjen e kaptazhave .




Fig.3 Harta hidrogeologjike e regjionit te Pejës (Shtupeç i Vogël)

Zona e kerkuar per shfrytezim te burimeve eshte pjese e Pelgut te Drinit te Bardhe, ne aspektin hidrogeologjik eshte perfaqesuar nga shkembijnjet metamorfik, gelqeroret e Triasikut dhe shkembijnjet vullkanik.

3.7. Pedologjia

Në aspektin pedologjik , zona kadastrale ku bëjnë pjesë në tokat e pazhvilluara , me një shtresë të materialit malor karakteristik për gelqeroret me ngjyrë të kafët jashtëzakonisht e cekët në masën e ketyre gelqeroreve edhe atë sillet nga 0.20 deri 0.50m. Kurse jashtë zones kadastrale te Shtupeçit sidomos për gjatë luginës Rugoves në perëndim ku është e mbuluar nga, deluviale .




Fig.4 Harta pedalogjike e regjionit te burimeve ne Shtupeç te Vogel

Kurse pjesët nga të cilat kemi një proces të alterimit të shkëmbinjve kemi toka që shumë pak shfrytëzohen, ma tepër janë livadhore me vegjetacion shumë të dobët të shkurreve dhe gjysmë shkurreve

Harta pedalogjike e rajonit të ngushtë, ku gjendet burimet është tok ngjyrë kafet të cekët, lagështinë e marrin nga ujërat atmosferik. Ph është bazike sidomos në zonaen kadastrale te perfaqesuar nga gelqeroret.

3.8. Ndërtimi gjeologjik lokacionit

Tereni i zones se Shtupeçi ndërtohet nga Shkëmbinjet metamorfik te Paleozoikut; gelqeroret i Triasikut dhe shkëmbinjet Vullkanik

3.8.1 Studimet e me hershme gjeologjike

Në zonën e perkufizuar për studime gjeologjike dhe me gjerë janë kryer edhe me pare studime nga shume ekspert. Studimet e para jane kryer gjate punimit te Hartave gjeologjike në shkallë 1: 100000 dhe 1:25000. Zona e kërkimit është pjesë e hulumtimeve të me hershme të punimit të Planshetit të Rozhajës K.34-41 dhe Planshetit të Mitrovicës K.34-42. Në këto planshete jane të paraqitura perfaqesimet litologjike te zones se kerkimit, tektonika e regjioni dhe pershkrimi i zonave mineralmbajtese etj.

3.8.2. Karakteristikat gjeologjike të regjionit te zones

Zona e studimit në pjesën veriore përfaqsohet nga metamorfitet , formacionet e Triasikut (T2-3 nga Miocenit, quaternarit dhe shkëmbinjet vullkanik.




Fig. 4. Harta gjeologjike e rajonit te Pejës

Triasiku T2-3 - shtrihen në pjesën veriore perendimore të zonës së studimit me një gjerësi disa qindra metra dhe gjatësi disa km të përcjella me thjerrëza të vullkanikeve dhe në kontakt me shkëmbinjet metamorfik në pjesën veriore të Shtupeçit dhe në pjesën jugore . .

3.8.3 Tektonika

Rajoni i gjerë i zones së studimit përfaqësohet nga **Masivi i gelqeroreve të dolomitorizuar Zhleb-Kodra e thare** që perkufizohet në pjesën perendimore në kontakt me zonën tektonike Rugovë-Qakorr, në veri me njësinë tektonike Iber-Tutin kurse në jug me Ultesirën e Dukagjinit.

Masivi i gelqeroreve të dolomitorizuar Zhleb-Kodra e thara i takon zonës së tektonike të gjerë Zhlebit- Kodra e thare e përfaqësuar nga gelqeroret masive të dolomitorizuar e cila ka një shtrirje të gjërë. Është në kontakt tektonik me thyerjen reverse VVP –JLL , reka Kalaje-Turjak dhe thyerjen VVL-PPJ Mojistër- Jabllanice –Turjak. Ndërsa në pjesën jugore me thyerjen tektonike e cila është e mbuluar nga sedimentet e ultësirës së Dukagjinit.

3.10. Natyra dhe biodiversiteti

Biodiversiteti Komuna e Pejës, shquhet për shumëllojshmëri biologjike dhe të peizazhit. Zona e Bjeshkëve të Nemuna me relievin e thyer, burimet, ujëvarat dhe shpellat, strehon një shumëllojshmëri të habitateve dhe vegjetacionit, duke përfshirë specie endemike, sub-endemike dhe relikte të bimëve. Krahas me pyjet e ahut dhe të lisit, Bjeshkët e Nemuna janë të pasura me pyje të gështenjës dhe pishave me karakter relikto dhe endemik - munika (*Pinus Leucodermis*), molika (*Pinus Peuce*), pisha e bardhë dhe e zezë (*Pinus silvestris et nigra*), etj. Në Majen e Rusolisë rritet bima luleylli (*Lentopodium alpinum*), kurse në Gubavc forsitia (*Forsytia europea*). Edhe fauna është jashtëzakonisht e pasur e përfaqësuar nga: rrëqebulli (*Lynx lynx*), ariu i murrme (*Ursus arctos*), kaprolli (*Capreolus capreolus*), dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), shqiponja e maleve (*Aquila chrysaetos*), fajkoi thonj bardhë (*Falco naummani*), pulegra (*Tetrao urogallus*), etj. Lumenjtë janë të pasur me peshq veqanërisht me troftë. Gjithashtu janë prezentë edhe shumë lloje të ujëtokësorëve, reptilëve dhe zvarranikëve. Dallohen breshka e pyllit dhe e kënetave, bretkosat, hardhucat dhe gjarpërinjtë. Në Bjeshkët e Nemuna jetojnë edhe 129 lloje fluturash nga rendi Lepidoptera që e bëjnë rajonin ndër më të pasurit në Evropë për qka është identifikuar edhe si PBA (Primeary Buterfly Area). Për shkak të pasurisë së madhe me shpendë, si dhe kalimit të rrugëve migratore nëpër zonë, Bjeshkët e Nemuna janë konstatuar edhe si IBA rajone (IBA- Important Bird Areas. Bazuar nga të dhënat e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AKMM) respektivisht sipas Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN), PZHK-Peje 2019, por edhe sipas observimeve në terren, në afërsi të lokacionit ku gjenden impiantet e cekura, nuk ka zona të mbrojtura. (AMMK-IKMN 2008, 2010).

3.11. Flora dhe vegjetacioni

Sipërfaqet bujqësore, si sipërfaqet të rëndësishme ekonomike paraqesin bazën të rëndësishme natyrore për Komunën e Pejës. Kushtet të volitshme klimatike, sidomos numri i madh i ditëve me diell gjatë sezonit veror si dhe ujitja me anë të pipave për kulturat lavërtarë (speca, domate, patate, bostan, qepë etj.) si dhe kultivimi i pemëve. Sipërfaqet bujqësore përfshijnë një sipërfaqe prej 19.998 ha dhe sipërfaqet janë të mbjella me këto kultura: gruri, elbi, tërshëra, misri, etj. Bjeshkët e Rugovës janë bjeshkë të pasura më dhë të mbuluara me vegjetacion të larmishëm që e përbëjnë florën e këtyre bjeshkëve. Edhe

kullotat janë të bollshme në këto hapësira pitoreske të cilat paraqesin bazë të mirë edhe për zhvillimin e blektorisë dhe degëve të tjera që lidhën më prodhimet që dalin nga përpunimi i qumshtit. Livadhet, kullosat zënë një hapësirë të konsiderueshme. Këto sipërfaqe kanë ndikim në zhvillimin dhe mbajtjen e ekuilibrit të ekosistemit. Sipërfaqet e pyjeve përbëhen nga lloje të ndryshme duke filluar nga bungu, ku me rritjen lartësisë mbidetare del ahu etj dhe vazhdon me pishen, bredhin e bardhë etj. Ndërsa sa i prekte operimi të impiantit në lokacionin e cekur, nuk do të ketë qrrregullime të shumta në flore dhe biodiversitet dhe nuk do të ketë efekte negative në cilësinë ajrit dhe ambientit për rreth.

3.12. Bota shtazore -Fauna

Për gjatë komunës së Pejës rrjedh shumë lumenj si, Drini Bardhë, lumëbardhi i Pejës dhe shumë ujë rrjedha dhe proçkat të cilët derdhen në këta lumenj që ka rëndësi të madhe ekonomike dhe në të gjenden numri i madh i llojeve të peshqve. Në Drinin e Bardhë ka më së shumti bërcak mustak, rapuli, marule, krap, ngjalë dhe trofta e cila lajmërohet kohë pas kohe. Përafërsisht llojet e njëjtë të peshqve ndodhen edhe në lumenjtë tjerë të komunës së Pejës. Përpos peshqve ka edhe bretkosa, gaforre dhe gjarpinj të ujit. Ndërsa në ekonominë familjare kultivohen gjedhet, kuaj, dele, dhi, derra si dhe shpezë. Në territorin e komunës janë prezentë edhe shtazët e egra si që janë : arinjtë, rrëqebulli, kaprolli, dhelpra, ujë, lepuj, derri i egër me numër të madh dhe që tani edhe bënë dëmet të mëdha në kulturat bujqësore e që tani nuk lejohet gjuetia. Shpezë në territorin e komunës së Pejës, që janë më të njohura janë këto: thëllëza, sorra, harabeli, pata e egër, korbi, bylbylat, pëllumbat, kumria (Gugutka), skifteri (gjeraqina), shqiponja, pulat e egra dhe lejleku gjatë stinës verore e posaqërisht përgjatë rrjedhjes së lumit Drini Bardhë.

Gjendja e tanishme e ekuilibrit biologjik-ekologjik të komunës së Pejës ka kushtet të përshtatshme për zhvillimin e saj i cili do të ishte në rritjen e sipërfaqeve me pyje të llojeve të ndryshme të drunjtë, rruajtjen e gjendjes ekzistuese të peshqve dhe begatimi i tyre, kjo vlen edhe për llojet të ndryshme të shpezëve dhe egërsirave të cilat i ka ky territor. Sipas gjendjes faktike në terren zona ku është duke menduar të punohet sistemi i rrjetit për shfrytëzim të burimeve nuk ka ndikim në faunë dhe ndikime tjera që do të ishin në dëm të gjithë atyre gjallesave që jetojnë në atë zonë, pasi që qdo monitorohet dhe do kontrollohet, në vazhdimësi.

3.13. Peizazhi

Peizazhi është i tipit të kombinuar më kodrina të larta të cilat shtrihen në të dy anët e zones kadastrale të Shtupeçit në lindje dhe perëndim. Gjerësia e kësaj kodrine është e ndryshme për gjatë uljes së terrenit ndërmjet këtyre dy kodrinave. Peizazhi nuk është i dëmtuar dhe duhet të ruhet dhe me asnjë kusht të domtohet po vetëm të rregullohet në bazë të kriterëve mjedisore. Në përgjithësi peizazhi është i bukur dhe tërheqës.

3.14. Dukshmëria

Shikuar nga pozita e lokacionit ku do të vendoset sistemi i shpërndarjes së gypave për furnizim me ujë dhe relievit të saj, dukshmëria është mjaft e lartë në të gjitha anët e horizontit nëse bazohemi në lokacionin ku janë të vendosura kaptazhet dhe burimet e ujit.. Në pjesën jug-perëndimore dhe ajo jug-lindore ka një dukshmëri më të madhe për gjatë luginës së bjeshkëve të Nemuna. Vendet që shtrihen në këtë lokalitet karakterizohen më megjulla dhe më lagështi të madhe të ajrit gjatë stinës së dimrit.

Edhe kjo zonë nuk përjashton nga ky fenomen por në masë më të vogël, sepse nuk ka kurrfarë uzine e as diçka tjetër që e rritë ndotjen e ajrit dhe për rrjedhojë e zvogëlon dukshmërinë.

3.15. Ajri

Vegjetacioni i mirë, prania e madhe e llojeve të ndryshme të faunës janë treguesit kryesor për pastërtinë të ajrit.

Kjo është zonë kryesisht malore, në afërsi nuk ka ndonjë uzinë ose aktivitet tjetër prodhues që do të ndikonte në ndotjen e ajrit.

Mund të konkludojmë se pastërtia e ajrit në këtë regjion është në nivel të lartë.

3.16. Uji

Në këto pjesë të zones kadastrale të Shtupeçit dhe në rrethinën më të gjere të ku është planifikuar të vendoset sistemi me furnizim me ujë nga burimet tregohet se kemi të bejmë me ujëra të bollshëm në këtë regjion, kualiteti i ujit është i nivelit të mirë\

4.0. Përshkrimi i sistemit për furnizim me ujë

Zgjidhja teknike e problemit për furnizim me ujë është bërë duke marrë parasysh pozitën gjeografike të Burimeve ndaj zonës që do të furnizohen me ujë. Zona që do të furnizohet me ujë, sipas gjendjes faktike që shihet në teren ka tendencë të rritjes së shpejtë të popullsisë dhe turistëve që e frekuentojnë atë zonë.

Duke marrë parasysh të gjithë faktorët e përmendur më lartë kemi ardhur deri te zgjidhja teknike, që furnizimi me ujë i asaj zone të bëhet nga burimet e ujit që gjinden në pjesën e

epërme të territorit të fshatit Shtupeç i Vogel për shkak se kapaciteti dhe pozita e burimeve mundeson që furnizimi me ujë për tërë zonën të bëhet me rënie të lirë.

Ky sistem i furnizimit me ujë do të përbëhet nga:


- Kaptazhat e Burimeve
- Gypat kryesor prej kaptazhës e deri te rezervarët grumbullues,
- Gypat e rrjetit shpërndarës,
- Rezervarët grumbullues sipas situacionit të paraqitur në pjesën grafike të projektit.

Pasi që kapaciteti i burimeve nuk dihet me saktësi, ndërtimi i rezervarëve do të bëhet në mënyrë që menaxhimi i sasisë së ujit të jetë sa më racional.

Pozita e ndërtimit të rezervarëve grumbullues është zgjedhur duke marrë parasysh relievin e vendbanimit, në mënyrë që e gjithë pjesa e vendbanimit të furnizohet me rënie të lirë dhe maksimalisht të evitohen kostot e operimit dhe mirëmbajtjes.

Në pjesën grafike të Projektit po ashtu janë paraqitur me saktësi segmentet ku duhet të përdoren gypat me shtypje punuese PN 10 përkatësisht PN 16 bar, varesisht nga shtypjet punuese që do të jenë për shkak të disniveleve të mëdha të terrenit.

Gjatë hartimit të këtij projekti rëndësi e veçantë i është kushtuar ruajtjes së mjedisit, siq është paraqitur edhe në pjesën grafike të projektit disa burime të kësaj zone me kapacitete të konsiderueshme janë lënë të lira me qëllim të ruajtjes së natyrës dhe plotësimit të nevojave të MINIMUMIT BIOLOGJIK.




Paraqitja skematike e kaptazhit të burimit dhe sistemi i vendosjes së gypave të ujit

Ketu do te behet kaptimi i 8 burimeve te cilat do te sherbejn per furnizim me uje komunitetit e ketij lokacioni dhe per turistet qe do te mund ta vizitojn kete vend

- Burimi B1,B2,B3,B4, jane te orientuara ne rezervuarin R1 me kapacitet fillestar pranues 100 litra.
- Burimi B5 eshte i orientuar ne rezervuarin R3 , (kapacitet 100 litra)
- Burimi B6 i orientuar ne rezervuarin R2 (kapacitet 100 litra)
- Burimi B7 i orientuar ne rezervuarin R5 (kapacitet 50 litra).
- Burimi B8 i orientuar ne rezervuarin R6 (kapacitet 50 litra).

Te gjitha keto burime parashihen e te i plotesojn nevojat e komunitetit te kesaj zone , kurse pjese tjeter mbetet e lire per drenim ne pjeset e siperfaqes se zones kadastrale , ku per mes te qarjeve drenohet ne kavernat e mundshme , apo shpellat te cilat mund te jen formuar ne keta shkembije.



Shtrirja e rrjetit te furnizimit me uje

- (Sipas Hartës Burimi B1). Burim i Ujit afër Gurrës së Bardhë i planifikuar të futet në sistemin për furnizim me Ujë, aktualisht është i kapuar për përdorim privat (Koordinatat 42.694079, 20.212182)



- Gurra e Bardhë (nuk është ne kaptazhë) është e lirë . Ka rrjedhje te përhershme, kurr nuk shteron. (Koordinatat 42.694002, 20.212261).



- (Sipas Hartës Burimi B2). Ka rrjedhje te përhershme. Kaptazha është e thjeshtë me një gyp sipas figures. As 50% te kapacitetit nuk përfshihet në kaptazhë. Rrjedhja jashtë kaprazhës është 1(l)/8sec, i planifikuar të futet në sistemin për furnizim me Ujë, aktualisht është i kaptuar për përdorim privat (Koordinatat 42.694293, 20.211441).



- (Sipas Hartes Burimi B3) Burimi i Parë i Iberdemajve. Ka rrjedhje te përhershme. i planifikuar të futet në sistemin për furnizim me Ujë, aktualisht është i kapuar për përdorim privat.

(Koordinatat 42.694180, 20.211189).



- (Sipas Hartes Burimi B4) Burimi i dytë i Iberdemajve. Ka rrjedhje te përhershme. i planifikuar të futet në sistemin për furnizim me Ujë, aktualisht është i kaptuar për përdorim privat.

(Koordinatat 42.693575, 20.211387)



- Rrjedhje afer kaptazhave B2 dhe B3. E planifikuar te mbetet e lirë.

(Koordinatat 42.693326, 20.211250)



- Kroni i Isuf Tahirit. Rrjedhje e lire me prurje te mesme (koha duhet patur parasysht, gusht 2024). Kjo nuk parashihet te futet ne kaptazhë. Do te jete e lire. (Koordinatat 42.692555, 20.211939).



- (Sipas Hartes Burimi B6) Burimi i Nilajve rrjedhja 1(l)/6sec. Burim i madh, i planifikuar të futet në sistemin për furnizim me Ujë, aktualisht është i kapuar për përdorim privat.

(Koordinatat 42.689472, 20.210251)



- (Sipas Hartes Burimi B6) burim i ujit afër Gurrës së Kastratit. Me kaptazhë do te futet ne sistem te ujesjellesit. (Koordinatat 42.687342, 20.211052)



- Gurra e Kastratit. Kjo mbetet jashtë sistemit të ujësjellësit si burim i lirë 0.5(l)/11se (Koordinatat 42.687362, 20.210549)



- Qeshmja e fshatit Shtupeç i Vogel. Burim me rrjedhje te përhershme dhe me prurje konstante ne qdo stinë. 1(l)/8
Ky burim nuk planifikohet te futet ne sistemin per furnizim me ujë dhe mbetet i lirë.

(Koordinatat 42.681091, 20.210108).



- (Sipas Hartes Burimi B7) Burimi Avramit , me kaptazhë do te futet ne sistem te ujesjellesit.

(Koordinatat 42.679846, 20.209385).



- (Sipas Hartes Burimi B8) Kroni i Ftoftë , me kaptazhë do te futet ne sistem te ujesjellesit.
(Koordinatat 42.678760, 20.208307).



5.0 VLERËSIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NE MJEDIS

5.1. Ndikimet në ajër

Gjatë punimeve në realizim të këtij projekti do të vijë deri të ndikimet e përkoshme në mjedis : si në cilësinë e ajrit. Por keto ndikime do të zvoglohën më masat e parapara në projektin teknik dhe në kujdesi e shtuar të kompanisë punëkryrëse. Në

Në zonën e shtrirjes së burimeve dhe vendosjes së gypave të ujesjellesit ajri është i pastër. Deri te ndotja vjen për shkak të punëve dhe aktivitetit në vendosjen e gypave dhe ndërtimit të kaptazhave , sidomos në fazën e , hapjes kanalit, ndërtimit të kaptazhavr dhe rezervuareve të ujit.

Ndotësit janë kryesisht pluhurat që barten me anë të erës , por duke iu falënderuar formës së relievit dhe konfiguracionit të terrenit bartja e pluhurit me anë të erës nuk arrin deri te vendbanimet e banuara më të afërta, pasi se ato janë larg nga lokacioni ku do të ndërtohet rrjeti ujesjellesit .

Ndotja e ajrit vjen nga automjetet e ngarkimit dhe transportit të cilat si lëndë djegëse përdorin derivatet e naftës.

Përbërja e gypave dhe materialeve për ndërtim nuk përmban materie të dëmshme.

5.2. Ndikimet në tokë

Si ndikim negativ në tokë paraqitet masa sterile e cila duhet të largohet nga sipërfaqet e punës.

Trashësia e sterilit sillet prej 30 cm gjerë 1m , depozitimi i tij duhet të bëhet në konsultim me projektuesin në zonën e punishtës, në një anë ku nuk pengon proceset vendosjes së gypave .

Si ndikime kemi edhe mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të mekanizmit punues, mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë punëtorët.

Ndikim tjetër me rëndësi në tokë paraqitet depozitimi i pluhurit i cili krijohet nga makineritë punuese në realizim të projektit si dhe me ngjeshjen e tokës të cilën e shkaktojnë akina punuese.

Ndikimet nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshëm nga mjetet punuese gjatë furnizimit dhe punës së tyre.

5.3. Ndikimet në ujë

Ndikime negative në ujë shkaktohen nga derivatet dhe vajrat e ndryshme të cilat derdhen në tokë nga makinat të cekura në pasuset e më sipërm të cilat me derdhjen e tyre në tokë

ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore me rastin e të reshurave atmosferike si dhe ndotjen e ujërave nëntokësore.

Gjithashtu në ndotjen e ujërave ndikon pluhuri i cili bartet me anë të ujërave sipërfaqësor.

Ndikimet tjera negative janë edhe derdhja e ujërave të zeza, mbeturinat e ndryshme, etj.

5.4. Ndikimi në Peizazh

Lokacioni ku është sistemi i ujesjellesit , gjithnjë do të merr pamjen e një vendi ekoturizem..

Duke pas parasysh projektin teknik, ku shtrirja e gypave për ujësjellës do të behet në rrugën kryesore e cila është në ndertim ose edhe ne bankina të kësaj rruge, del se ndikimi në pisazh do të jetë minimal ose i papërfillshëm. Por sidoqofatë masat për rekultivim duhet të aplikohen gjithësesi si në vijën e shtrirjes së rrjetit të kanaleve ashtu edhe na kaptazha dhe në hapësiart për rreth ndertimit të rezervuarëve.

të shfrytëzimit të pasurive /resurseve natyrore.

5.5. Ndikimi në florë dhe faunë

Ndikimi në florë gjatë punimeve në realizim të projektit të ujësjellësit do të jenë evidente, por duke pas parasysh masat që janë marrë nga hartuesi i projektit : zgjedhja e rrugës për vendosjen e gypave, masat e marra për menagjim me dherat që do të dalin nga kaptazha e burimeve, hapja e hapësiarve për rezervuar të ujitë, ndikimet që do të dalin do të evitohen në terësi dhe për një kohë të shkurtër do të rehabilitohen këto ndikim. Dëmtimet në terësi duhet të rikultivohet pas përfundimit të punëve ,vendosjes se gypave.

Fauna nuk do të dëmtohet fizikisht për arsye se do të largohen nga regjioni i veprimtarisë prodhuese dhe do të zhvillohet në terrenin e përafërt që i përshtatet faunës.

5.6. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Në kompleksin e shtrirjes se rrjetit te sistemit per furnizim me uje nga burimet nuk ka objekte banimi , objektet e banimit gjenden pjesen anesore dhe per gjate rrugeve te pashtuara, nuk do të kemi ndonjë rast të zhvendosjes së popullatës. Por më realizim të këtij ujësjellësi popullata do të ketë një përfitim të madh si për jetë më të mirë ashtu edhe për zhvillim të turizmit dhe fitime për ekonomitë familjare. ,

Cilësia e gypave dhe maaterialet e përdorura për realizim të këtij projekti duhet të jenë kualitative dhe të sigurt që nuk përmbajnë materieje të rrezikshme për shëndetin e njerëzve. Pas realizmit të këtij projekti, menagjimi dhe mbikëqyrja duhet të bëhet nga kompania regjionale e Ujësjesit të Pejës.

5.7. Zhurma

Zhurma, si element në teknologjinë e gjatë operimit të vendosjes së rrjetit të ujësjesit ka një karakter lokal dhe pa ndikim në zonat e banuara, duke pasur parasysh largësinë e tyre nga lokacioni.

Zhurma vjen si rezultat i aktiviteteve punimeve kryesisht nga makinat gjatë procesit të hapjes dhe mbylljes së kanalit..

Me shfrytëzimin e pajisjeve prodhuese bashkohore në bazë të standardeve të zakonshme maksimumi i zhurmës në burim duhet të jetë 90 dB.

Zhurma për zonën e banuar është plotësisht në kufijtë e standardit dhe gjatë ditës nuk kalon 50 dB, kurse gjatë natës nuk do të punohet, por edhe kur punohet nuk do të jetë më e madhe se 45 dB.

Ne vijim po e paraqesim në formë tabelore nivelin e zhurmës në varshmëri nga distanca.

Zhurma	Distanca (m)			
	10	50	100	500
90db –niveli Për pajisje moderne	59	45	39	25

5.8. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Pasi që në aktivitetin e rregullimit të sistemit të ujësjesit për furnizim me ujë nga burimet mekanizmi punues do të jenë mirë të mirëmbajtura, dhe të monitoruara nga ekspertët e lamive përkatëse dhe një herë kur dihet se brenda veprimtarisë punuese nuk kemi të bëjmë me materie të rrezikshme për mjedisin, por thjeshtë me materialin që e marrim po nga ky mjedis. Aksidentet të cilat mund të ndodhin, mund të jenë të natyrës së ndryshme dhe mund të ndodhin në çdo etapë të proceseve të punës në hapje të kanalit, ndërtimit të rezervuarave dhe kaptazhit si:

- Gjatë përgatitjes së kanaleve , largimit te materialit argjillor
- Gjatë punëve në vendosje te gypave
- Gjatë proceseve tjera hapja e rezervuarve dhe rregullimi
- Nga rrjedhjet e ndryshme të lëndëve djegëse dhe lubrifikuese nga mekanizmi punues (mundësia e ndezjes)

6.0 Marja e masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve

6.1. Masat e marura për mbrojtjen e ajrit

Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative të mundshme në ajër të krijuara nga realizimi i proceseve teknologjike për shtrirjen e rrjetit te ujesjellesit per shfrytezim te burimeve ne fshatin Shtupeç duhet ndërmarr këto masa:

- Në hapje te kanaleve, gjatë punës me eskovator duhet zvogëlohet minimalisht lirim i pluhurit.
- Nuk duhet të punohet në kohëra me erëra.
- Të gjitha sipërfaqet operationale dhe rrugët (pjesët e pa asfaltuara) ku do të bëhet transportimi i masës shkëmbore duhet vazhdimisht të stërpiken me ujë.
- Duhet të behët kontrollimi i rregullt teknik i automjeteve të rënda punuese me qëllim që lirim i gazrave nga mjetet e punës të jetë sa më kualitativ.
- Kamionët të cilët bëjnë transportin e fraksioneve duhet të mbulohen me mbulesa adekuate.

6.2. Masat e marura për mbrojtjen e tokës

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë nga realizimi i punimeve për vendosjen e shtrirjes se gypave per furnizim me uje nga burimet duhet marrë këto masa mbrojtëse:

- Masa bimore e larguar duhet të deponohet në vende të caktuar për shfrytëzim të mëtutjeshëm si dhe mos të lejohet kalbja e tyre.
- Pjesën humusore dhe argjilore të materialit steril duhet deponuar në vende të posaçëm me qëllim të ruajtjes për rekultivim biologjik.
- Erozionin duhet ta pengojmë me anë të rikultivimit biologjik ku është e mundur.

- Varësisht nga fronti i punëve në hapje te kanaleve , në kohën më të shkurtër që është e mundur duhet të filloi procesi i rikultivimit, me ç’ rast e tërë sasia e sterilit e cila mbetet do të përdoret për mbushje dhe nivelizim të hapësirave të krijuara nga proceset e shfrytëzimit të materialit për shtruarje dhe tamposje.
- Të ndërpritet puna në kohra me të reshura atmosferike me qëllim të mos ngjeshjes në masë të madhe të tokës.
- Duhet të merren masat e nevojshme për mos lëshuarjen e pa kontrolluar të derivateve dhe vajrave nga makinat dhe pajimet prodhuese.
- Vaji i makinave duhet të ndërrohet në vende të caktuara dhe të izoluara për mos depërtimin e tyre në tokë dhe atë ne ofiqinën për riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve ngarkuese dhe transportuese.
- Nëse detyrimsht duhet të bëhet ndërrimi i vajit në lokacionin e shtrirjes së rrjetit për furnizim me ujë për shkak të avarive në makinat ngarkuese dhe transportuese, atëherë duhet siguruar enët adekuate për mbajtjen e vajit dhe duhet siguruar një pjesë nga materiali jo lëshues i vajrave dhe të vendoset nën makinën që riparohet.
- Të gjitha mbeturinat e ngurta të cilat krijohen në punishte apo në shtrirje të kanalit për vendosje të gypave, rezervuareve dhe kaptazhe duhet të grumbullohen dhe klasifikohen sipas përbërjes dhe llojit të tyre, ato metalike të deponohen në vende të posaqme, ato të cilat nuk përdoren për nevojat e kompanisë të shiten kompanive të licencuara, për mbeturinat tjera të ngurta të sigurohen kontejner të posaqëm të cilët do të i zbrazin kompanitë që kanë veprimtarinë e grumbullimit të tyre dhe të i dërgojnë në deponi regjionale.
- Mbeturinat e lëngta që krijohen nga ndërrimi i vajrave të pajimeve duhet të deponohen në enë të posaqme të cilat mbeturina do të i shiten kompanive të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura.

6.3. Masat e marura për mbrojtjen e ujit

Mbrojtja e sipërfaqësore e ujerave nga ndotësit e ngurtë të cilët mund të ndodhin gjatë bartjes me ujë nga të reshurat atmosferike duhet të bëhet me rregullimin e kanalit rreth e përfaqë sipërfaqes ku shtrihet rrjeti. Ky kanal nevojitet për vendosjen e gypave dhe nuk pengon ujerat nëntokesore apo sipërfaqësore nga vërshimet gjatë të reshurave atmosferike,

dhe mbrojtjen e ujërave nga ndotësit mekanik dhe ndotësit me vajra e derivate, prandaj për pastrimin e ujërave të cilët rrjedhin nga hapësirat e vendosjes së rrjetit gjatë të reshurave atmosferike duhet të rregullohen

Nuk do të ketë ujëra të zeza në instalim të këtij rrjeti për furnizim me ujë të pijshëm nga burimet.

6.4. Masat e marura për mbrojtjen nga zhurma

Duhet të bëhen matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtje nga zhurma.

Për analizat dhe vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet të krahasojmë me ligjet dhe nivelet e lejuara për vendet ku jetojnë dhe punojnë njerëzit.

Në raste se zhurma e mesit nga matjet tejkalon atë të lejuarën atëherë duhet të meren të gjitha masat që niveli i zhurmës të bihet në nivelin e të lejuarës sipas rregullave në fuqi.

Në varshmëri nga fazat e procesit të punës duhet edhe të punësuarit në ato vende të punës të përdorin mjetet kundër zhurmës.

6.5. Masat e marura për mbrojtjen e botës bimore dhe shtazore

Masat për mbrojtjen e botës bimore kryesisht lidhen ngushtë me ruajtjen e tokave në pjesët e ngastrave ku vendosen gypat nga erozioni dhe masave mbi mbrojtjen e ajrit. Kompania duhet të ketë kujdes që të mos deponoj pa kontroll mbeturina në vende të ndryshme por ato duhen të deponohen në vende me destinacion të caktuar.

Në raste të lajmërimit të zjarrit menjëherë të meren masa për neutralizimin e tij. Pajisjet kundër zjarrit duhen të ruhen në mënyrë të veçantë.

Për mbrojtjen e botës shtazore kompania duhet të tregoj kujdes duke kufizuar lëvizjet e të punësuarve jashtë zonës punështes dhe të kenë kujdes në nivelin e zhurmës, kualitetin e ajrit etj.

6.6. Masat e marura për mbrojtjen nga rreziqet aksidenciale

Për të evituar rreziqet aksidenciale gjatë vendosjes, shtrirjes së rrjetit për furnizim me ujë nga burimet duhet ndërmarr këto masa:

- Duhet të bëhet plani i intervenimit për raste të aksidenteve ekologjike.

- Duhet të kenë ne disponim kemikate neutralizuese për karburante të naftës dhe vajra.
- Duhet të bëhet plani i mbrojtjeve nga zjarri.
- Duhet e sepaku rezervuari dhe kaptazha të thuret me tel gjembor.
- Të merën të gjitha masat e sigurisë konform ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mjedisit të punës.

7. Aktivitetet në raport me publikun

Komuniteti duhet ketë respekt, për arsye të rritjes së infrastruktures dhe krijimit të kushteve për një jetë më të mirë dhe shtim të ekoturizmit në këtë lokalitet, duke pasur parasysh llojin e projektit, kapacitetin e prurjes së ujit dhe potencialit të ndikimeve në mjedis, nuk ka pasur dhe nuk planifikon që të ketë ndonjë debat të ngushtë publik apo edhe të veçantë me publikun.

8.0 Programi i monitorimit

Ndikimet direkte nga aktiviteti i realizimit të proceseve teknologjike për shtrirjen e rrjetit të ujësjellesit, bazuar në vlerësimet e ndikimit në mjedis janë ndikimet në tokë, ajër dhe ujë. Këto ndikime janë relativisht minimale në mjedis pas marrjes së masave për zvogëlimin e këtyre ndikimeve, dhe si të tilla mund të monitorohen. Për këtë arsye parashihet një program monitorues për shfrytëzim të ujerave, burimeve. Monitorimi i ajrit, ujit dhe zhurmës duhet të bëhet me marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave në institute adekuate dhe të raportohen në Ministri të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor sipas kërkesës së tyre.

Pas perfundimit të këtij projekti i gjithë menagjimi dheh përkujdeja duhet të kalojë në KRU-në e Pejës.

9. Raportimi

Do të kryhet nga udhëheqja, gjegjësisht nga ekspertët e komunitetit apo ato komunale së paku në fund të çdo viti kalendarik, ku do të paraqiten të dhënat relevante nga të gjitha monitorimet e bëra brenda vitit, të cilat do të raportohen autoriteteve përkatëse, në Ministri të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunitetit lokal brenda komunës.

10. Marja e masave rehabilituese pas përfundimit të aktiviteteve punuese

10.1. Objektivat e rikultivimit

Trajtimi i rikultivimit në përputhje me kërkesat bashkohore të mbrojtjes dhe regjenerimit të mjedisit, duhet parë si një prioritet të rëndësishëm edhe në këtë regjion ku është kryer rrjeti i punimeve për ujësjellsin.

Nga punimet gjatë shtrirjes së gypave, ndertimit të rezervuareve dhe kaptazhave si masë rehabilituese duhet të bëhet për gjatë rrjetit të gypave të krijojnë substrat që i takojnë kategorisë së tokave të dëmtuara d.m.th. substrat të pa përshtatshme (sterile) për rikultivim. Substrat me përmbajtje të pa tjetër duhet të nënshtrohen rehabilitimit gjatë në masën e përmirësimit të pjesërisht të vetive të tyre dhe krijimit ose zëvendësimit të tij me atë të rrethit ashtu që të krijojnë një substrat produktiv i përshtatshëm për rikultivim malor. Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të shfrytëzuara dhe dëmtuara nga vendosja e gypave, rezervuareve dhe kaptazhave. Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga:

Qëllimi i rikultivimit- i cili nënkupton që pas përfundimit të rrjetit sipërfaqeve të degraduara, prapë të kthehet funksioni i saj primar (prodhimi i biomasës), dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem.

Planifikimi i shfrytëzimit të tokës— planifikohet që toka në lokalitet të rrjetit të rikultivohet duke iu përshtatur gjendjes së përafërt me atë të rrethit.

Niveli i punimeve të shtrirjes së gypave ende nuk ka filluar, rikultivimi është i lidhur me aktivitetet punimeve, përkatësisht përfundimin e punëve dhe shpalljen e kryerjes së vendosjes së rrjetit.

Të gjitha aktivitetet e lartshënuara synojnë objektivat e rikultivimit që kanë këto qëllime:

- Prodhim i biomasës - drurit.
- Rehabilitimin e peizazhit dhe kthimin e pamjes vizuale në harmoni me formën rellefore të terrenit.
- Kthimin e profilit pedologjik të tokës së degraduar me rastin e punimeve minerare.
- Zgjerimi i kapacitetit filtrues natyror të ajrit.
- Pyllëzimi i sipërfaqeve të qveshura si pasojë e punimeve minerare.

- Krijimin e një peizazhi të bukur, të përafërt me at të natyrës për rreth.

10.2. Struktura përfundimtare e sipërfaqeve

Struktura përfundimtare e sipërfaqes të prekuar nga punimet duhet të rehabilitohet në terësi. Sidomos rëndësi duhet të kushtohet kaptazheve dhe rezervuareve të cilët duhet të jenë kompatibel me rrethin dhe të përshtatur me gjendjen paraprake, Propozohet që çdo bimë drusore që dëmtohet të kompensohet në hapësirat ose vendet ku janë dëmtue. Rikultivimi të bahet bimë halore në ngastrat ku behet rrjeti i furnizimit me ujë të pijes nga burimet e fshatit Shtupeç..

11.0 Kostoja e punimeve

Kostoja e punimeve në realizim të këtij projekti është pjesë e autorëve të projektit dhe e njeta duhet të tregohet e të jetë pjesë kryesore dokumentacionit për marrje të lejës dhe realizim të projektit. Një vlerim të përafërt po e japim më poshtë i cili më tepër është orientues:

Hapja e kanalit dhe vendosja e gypave	8€/m=10000€
Hapja e kaptazhave dhe rregullimi.....	8kap= 2500€
Hapja e rezervuaraeve dhe rregulimindertimi	5rez= 10000€
Materiale, gypa, lidhese dhe mjete tjera	=8000€

31500€

12. 0 Konkluzion

Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë në komunitetin e Shtupeçit të Vogël , Peje përfaqëson një angazhim të rëndësishëm për të siguruar qasje të qëndrueshme dhe cilësore në ujë për banorët dhe ekoturizmin. Ky projekt shënon një hap të rëndësishëm drejt modernizimit dhe përmirësimit të infrastrukturës së ujësjellësit për komunitetin , duke përdorur teknologjinë dhe praktikën më të fundit. Kaptimi i burimeve të ujit , ndërtimi i rezervuareve , vendosja e gypave si dhe shpërndarja në mënyrë proporcionale me komunitet dhe hapësirë . Përveç kësaj, përdorimi i mjeteve të avancuara të monitorimit dhe menaxhimit të sistemit të rrjetit të ujit do të ndihmojë në zvogëlimin e humbjeve teknike dhe komerciale të ujit, duke rritur në të njëjtën kohë mbulueshmërinë e shërbimit për zonat

e reja. Ky projekt paraqet një mundësi të rëndësishme për të përmirësuar jo vetëm cilësinë e jetës për komunitetin e Shtupeçit po edhe mundësit për zhvillim të një ekoturizmi.

Ky investim paraqet një zgjidhje të qëndrueshme dhe efikase për përballimin e sfidave të furnizimit me ujë për komunitetin i cili gjendet në këtë zonë duke ndikuar pozitivisht në zhvillimin e qëndrueshëm të këtyre komuniteteve dhe të mjedisit të tyre.